

Edhe në Kosovë është shënuar Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Kërkohet koordinim për respektimin e të drejtave të njeriut

"Zëri ynë do të ishte shumë më i fuqishëm nëse, së paku, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do ta kishim një koordinim edhe më të madh ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe të gjithë atyre që duan ta shënojnë këtë ditë", ka thënë Avokati i Popullit, Sami Kurteshi

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI


PRISHTINE, 10 DHJETOR - Të drejtat e njeriut kanë nevojë për respektimin e përditshëm të tyre. Kështu ka thënë të hënën Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, me ç'rast është mbajtur një tryezë me temën "Pjesëmarrja dhe përfshirja nuk janë privilegj, por e drejtë" me moton "Fjala ime vlen!". "Kur autoritetet shtetërore, por edhe shoqëria në përgjithësi do t'i shohë ato jo si problem, por si obligim që duhet respektuar, me përpjekje të vazhdueshme për avancimin në këtë fushë, në mund të themi se kemi bërë

hapi e duhur përpara", ka thënë Kurteshi.

Kurteshi ka thënë se nëse të gjithë dalim në mbrojtje të të drejtave të njeriut, atëherë zëri për këtë çështje do të jetë më i fuqishëm. "Zëri ynë do të ishte shumë më i fuqishëm nëse, së paku, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do ta kishim një koordinim edhe më të madh ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe të gjithë atyre që duan ta shënojnë këtë ditë", është shprehur Kurteshi. Avokati i popullit ka thënë se ekzekutivi është shkelësi më i madh i të drejtave të njeriut. "Kemi natyrisht ekzekutivin se, natyrisht se ekzekutivi është ajo pjesë e pushtetit që ka marrëdhënie më së shumti me qytetarë,

qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal, mandej është gjyqësori", ka thënë Kurteshi.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se shkelja e të drejtave të njeriut është e llojllojshme. Ai ka thënë se shkelje e të drejtave të njeriut është edhe kur një votë e qytetarit nuk shkon në vendin e duhur. "Shkelje e të drejtave dhe vullnetit të njeriut është edhe atëherë kur një votë e qytetarit nuk shkon në adresën e duhur. Edhe me këtë dikujt i është shkelur ajo e drejtë, i është mohuar ajo e drejtë. Prandaj, forma e shkeljes së drejtave dhe lirive të njeriut është shumëdimensionale", është shprehur Krasniqi, duke shtuar se, sipas Kushtetutës së Kosovës, askush nuk është mbi ligjin dhe të



gjithe janë të barabartë para ligjit. "Por, jo pak herë gjatë këtyre viteve kemi parë se mu ata që e kanë marrë përgjegjësinë për ta mbikëqyrur sundimin e rendit dhe ligjit, edhe ata bëhen pjesë e shkeljeve të ligjeve në fuqi për shkak të fuqisë që e kanë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se ende në Kosovë shklen të drejtat e njeriut, duke kërkuar që të gjithë të angazhohen në mbrojtjen dhe lirinë e të drejtave të njeriut.

Elain Marie Conkievich, drejtore shë e Departamentit për Demokratizim në misionin e OSBE-së në Kosovë u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha grupeve dhe individëve. "Do t'u bëja thirrje institucioneve qendrore dhe lokale që të bëjnë

gjithe që është e mundur për ta zbatuar efektshëm legjislacionin dhe për t'i kontribuar zhvillimit të mëtejshëm të Kosovës si shoqëri shumetnike ku respektohen e mbrohen të drejtat e të gjithë grupeve dhe individëve", ka thënë Conkievich. Ndërsa Osnat Lubrani, koordinatore për zhvillimin e Kombeve të Bashkuara, ka theksuar se Kosova ka ligje shumë të mira mbi të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut por, ligjet, sipas saj, duhet të shihen si pikënisje, jo si përfundim i procesit. Po ashtu, edhe Tim Cartwright nga Këshilli i Evropës ka thënë se duhet të jemi të vetëdijshëm dhe këmbëngulës për të siguruar që korniza ligjore të shndërrohet në politika dhe praktika efektive në të gjitha nivelet.

Qytetarët të kënaqur me FSK-në

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar raportin "Barometri kosovar i Sigurisë". Sipas këtij raporti, qytetarët më së shumti janë shprehur të kënaqur me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), pastaj me KFOR-in, kurse më pak me Doganën e Kosovës, EULEX-in dhe Agjencinë Kosovare të Inteligjencës

PRISHTINE, 10 DHJETOR - Raporti "Barometri Kosovar i Sigurisë" ka vënë në pah rënien e nivelit të kënaqshmërisë me institucionet e sigurisë në Kosovë. Kështu ka thënë drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Florian Qehaja, i cili ka publikuar të hënën këtë raport, bazuar në hulumtimin e opinionit publik në Kosovë. "Ne e kemi vërejtur që kënaqshmëria e qytetarëve të Kosovës në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë është në ulje dhe kjo është shqetësuese për neve", ka thënë Qehaja. Sipas raportit, pro dialogut Kosovë - Serbi janë shprehur 48

për qind e qytetarëve shqiptarë dhe 55 për qind e qytetarëve serbë, të cilët janë shumë më pak optimistë se dialogu do ta sjellë normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Udhëheqësi i hulumtimit, Armend Muja, ka thënë se të dhënat e raportit tregojnë se qytetarët e Kosovës si rrezik potencial për sigurinë politike në vend nuk i shohin më konfliktet ndëretnike apo mosmarrëveshjet ndërmjet partive politike në vend. "Çështja e veriut, situata e rëndë ekonomike dhe korrupsioni janë parë si tre faktorët kryesorë që cenojnë sigurinë politike në



Kosovë", është shprehur Muja. Sipas të dhënave të raportit, përkrahjen më të madhe të qytetarëve të Kosovës e gëzon Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) me 72 për qind, pasuar nga KFOR-i me

60 për qind, ndërsa institucionet më kënaqshmerinë më të ulët janë Dogana e Kosovës me 29 për qind, EULEX-i me 22 dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës me vetëm 13 për qind.

Sa i përket gjyqësorit, rreth 60 për qind e qytetarëve janë përgjigjur se nuk kanë besim në këtë sistem, kurse sa iu përket rreziqeve të jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, shumica e qytetarëve, rreth 75 për qind, janë përgjigjur se rreziku kryesor vjen nga ndikimet e krizës ekonomike, derisa rreziku nga sulmet e jashtme ushtarake dhe të terrorizmit ndërkombëtar është parë si rrezik më i vogël. Sa iu përket kërcënimeve që mund të vijnë nga shtetet fqinje, 70 për qind e qytetarëve janë shprehur se ndejnë rrezik të caktuar që mund t'i kanoset Kosovës nga ana e Serbisë.

Në anketën e realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë janë përfshirë gjithsej 1067 amviserë, me strukturën etnike 89 për qind shqiptarë, 7 për qind serbë dhe pjesa e mbejtur pjesëtarë të minoriteteve të tjera. (rtk)

Në Zyrën Administrative vazhdon puna normalisht

MITROVICË. Në Zyrën Administrative në veri të Mitrovicës, të hënën ka vazhduar puna normalisht, pas incidentit në të cilin plagë me armë zjarri kishte marrë ndihmësi i shefes së Zyrës Administrative, Dushan Milisavleviq. Adriana Hoxhiq, shefe e kësaj zyreje u ka thënë gazetarëve se gjendja në veri të Mitrovicës mbetet e njëjtë. "Për fat të mirë, kolegu ynë është

jashtë rrezikut për jetë dhe është duke u kuarar në shtëpi", tha Hoxhiq. Sipas saj, situata në pjesën veriore të Mitrovicës mbetet e njëjtë, ndërkohë që stafi i kësaj zyre mbetet në përkushtim që të vazhdojë punën normalisht, por më syçelë dhe më kujdesshëm sa i përket çështjes së sigurisë.

"I gjithë stafi ka shprehur keqardhjen për plagosjen e

Milisavleviqit, por puna ka vazhduar normalisht. Mendoj se asgjë nuk ka ndryshuar dhe se duhet të përkujdesim dhe të jemi më syçel, sepse mund të ndodhin sërish incidente të tilla", tha znj. Hoxhiq, e cila ka apeluar te Policia e Kosovës, EULEX-it dhe KFOR-it që t'i shtojnë masat e sigurisë, në mënyrë që qytetarët të jenë më të sigurt.

Ajo tha se punëtorët e kësaj zyre janë kërcënuar vazhdimisht dhe disa herë edhe janë sulmuar në mënyrë më të egër, janë hedhur materiale eksplozive në shtëpitë e disa prej tyre dhe u janë djegur veturat. Ajo ka zbuluar se në Dushan Milisavleviq ka pasur sulme edhe më herët, kur në shtëpinë e tij, në Zveçan ishin hedhur disa herë bomba. **K. QECAJ**



Të zbardhet fati i të pagjeturve!

PRISHTINË. Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, institucionet e vendit u bënë thirrje institucioneve ndërkombëtare që të përdorin autoritetin e tyre ndaj Beogradit që të zbardhin fatin e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. "Edhe këtë vit, mijëra familje kosovare vazhdojnë të mbeten në ankth duke mos ditur për fatin dhe vendndodhjen e më të dashurve të tyre, të zhdukur pikërisht si pasojë e shkeljes flagrante të të drejtave të njeriut. Nga numri fillestar prej 6,024 personave të evidentuar si të zhdukur, që nga paslufta, ky numër sot është 1,762. Pavarësisht faktit se më shumë se gjysma e këtyre rasteve tashmë janë zgjidhur, numri prej 1,762 personave ende të zhdukur, vazhdon të përbëjë një shqetësim serioz, si për familjet e tyre, ashtu edhe për institucionet e Republikës së Kosovës", thuhet në deklaratën e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur. Në këtë ditë, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, gjegjësisht Qeveria e Republikës së Kosovës, iu bëri thirrje të gjitha institucioneve ndërkombëtare që të përdorin autoritetin e tyre karshi Beogradit zyrtar që të japë informacione dhe t'i hapë rrugë zgjidhjes përfundimtare të kësaj çështje të ndjeshme dhe të dhimbshme.

Edhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, në këtë ditë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkoi që të zbardhet fati i të zhdukurve dhe të bëhet e identifikimi i rasteve të dhunimeve seksuale gjatë luftës. "FDH Kosovë rikujton se çështjet më të ndjeshme të shoqërisë kosovare mbeten ato të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur, e identifikimi dhe dokumentimi i rasteve të dhunimeve seksuale gjatë luftës, procedimi i lëndëve për krime lufte dhe dëshmipërblimet për viktimat. **V. HALIMI**

FSK-ja, më e besueshmja

FSK-ja prin e para sa i përket besimit të qytetarëve të Kosovës, pas saj vjen KFOR-i, por jo edhe EULEX-i

Fadil Sertolli

PRISHTINË → Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri kosovar i sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës ka dalë të jetë më e besueshmja, ndërsa si më e pabesueshmja ka dalë të jetë Agjencia Kosovare e Inteligjencës. Në këtë sondazh, mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë - Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind besojnë në këto bisedime.

Qytetarët e Kosovës, sipas këtij publikimi, më së shumti janë shprehur të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (72%) përcjellë nga KFOR-i (60%) si dhe zjarrfikësit (57%). Një kënaqshmëri e balancuar është ndaj Policisë së Kosovës me vetëm 42% të të anketuarve që shprehën kënaqshmëri me punën e tyre. Ndërkaq më së pak kënaqshmëri ka ndaj punës së Doganave (29%) dhe EULEX-it (22%), Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), me 13%.

Drejtori ekzekutiv i kësaj qendre, Florian Qehaja, ka thënë se programi "Barometri kosovar



i sigurisë" ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë, siç janë policia, FSK-ja, Agjencia e Inteligjencës, zjarrfikësit, EULEX-i, KFOR-i, pastaj institucionet e drejtësisë, siç janë gjykatat, prokuroritë, si dhe perceptimet ndaj vendeve fqinje dhe superfuqive botërore.

"Përmes këtij hulumtimi ne po i kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojmë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe nivele të larta ndërkombëtare, për arsye se ne konsiderojmë

që është shumë e rëndësishme që qytetarët të kenë fjalën e tyre në proceset më të rëndësishme të vendit e sigurisë që siguria, gjyqësia dhe politika e jashtme janë shtylla kyçe", ka thënë Qehaja.

Ai shtoi se pakënaqësia e qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë është në rritje dhe kjo, sipas tij, është shumë shqetësuese.

Ndërsa, Armend Muja, nga kjo qendër, tha se ky publikim është i bazuar në hulumtimin e opinionit publik dhe është i bazuar në sondazh në anketa.

"Është matur kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet

e sigurisë. Institucioni i sigurisë, i cili gëzon kënaqshmërinë më të madhe te popullata, te të anketuarit është Forca e Sigurisë së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i, me një përqindje të kënaqshmërisë deri në 60 për qind, pastaj nga zjarrfikësit, një institucion tjetër, i cili jo drejtpërdrejt bën pjesë në një siguri të fortë. Pastaj, Policia e Kosovës me kënaqshmëri prej 42 për qind. Kjo është një kënaqshmëri e balancuar e qytetarëve, kurse institucionet tjera që kanë kënaqshmëri më të vogël janë doganat 29 për qind, EULEX-i 28 për qind, dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës 13 për qind", ka thënë Muja. Sipas Mujës, të anketuarit janë pyetur edhe rreth problemeve tjera të sigurisë, dhe politikës, ku qytetarët kanë dhënë mendimet e tyre për këto çështje. Ai tha se mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind të të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë - Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind iu besojnë në këto bisedime. Sipas kësaj ankete shumica e njerëzve në Kosovë janë optimist se të ardhurat e tyre do të rriten në vitin 2013. Kjo ankete me qytetarët përmban edhe shumë pyetje tjera, të cilat janë bërë publike nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Në MFSK-së shënohet Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, dje, në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës u mbajt një takim prezantues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në MFSK. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e FSK-së, Shkëlzen Sylaj foli për rëndësinë e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Ministri dhe në FSK. Ai, pos tjerash tha, se në Ministrinë e FSK-së, deri më tani nuk kemi asnjë rast të vetëm të identifikuar të shkeljeve të të drejtave të njeriut, as nga stafi ushtarak dhe ai civil.

Ministria e FSK-së, është ndër ministritë që më së shumti i kushton rëndësi respektimit të të drejtave të njeriut. Këtë fakt më së miri e dëshmon puna e mirë e bërë me ritjen e pjesëmarrjes së pjesëtarëve të minoriteteve. Sekretari i Përgjithshëm në fund përshëndeti stafin e Drejtave të Ministrisë, për punë e mirë që po bëjnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Ministri dhe FSK. Komandanti i FSK-së gjeneraljetënant Kadri Kasrati u shpreh se, në FSK-së respektimi i të drejtave të njeriut është në nivelin ma-

të lartë, dhe që është një shembull edhe për të tjerët. Ai theksoi se i është kushtuar rëndësi e posaçme e respektimit të drejtave të ngritjes në karrierë, gradim si dhe rëndësi të madhe i kemi kushtuar edhe avancimit të komuniteteve pakicë në FSK. Përfaqësuesi i Ekspert Këshillues të NATO-s (EKN), Stefan Ceder, këshilltar për Marrëdhënie Civile-Ushtrake, ka folur për historinë e fillimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Më pastaj, Stefan Ceder, i kushtoi një rëndësi, nocionit të të drejtave të njeriut,

në përgjithësi. "Të drejtat e njeriut bazohen mbi parimet e respektit për individë. Supozimi i tyre themelor është se secili person është qenie morale dhe e arsyeshme i cili meriton të trajtohet me dinjitet", tha ai. Në fund Njësia për të Drejtat e Njeriut në MFSK, të gjithë pjesëmarrësve u dha nga një libër, "Udhëzues për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të personelit të Forcave të Armatosura", të botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

SONDAZH I QENDRËS KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË

FSK-ja më e besueshmja, AKI më e pabesueshmja

Në këtë sondazh, mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind besojnë në këto bisedime

Tribuna
Prishtinë, 10 dhjetor

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka shpallur rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri Kosovar i Sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës, ka dalë të jetë më e besueshmja, ndërsa si më e pa besueshmja ka dalë të jetë Agjencioni Kosovar i Inteligjencës. Në këtë sondazh, mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind besojnë në këto bisedime.

Drejtori ekzekutiv i kësaj qendre, Florian Qehaja ka thënë se programi barometri kosovar i sigurisë ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë, siç janë policia,



FSK-ja, Agjencia e inteligjencës, zjarrfikësit, EULEX-i, KFOR-i, pastaj institucionet e drejtësisë, siç janë gjykatat, prokuroritë, si dhe perceptimet ndaj vendeve fqinje dhe superfuqive botërore. "Përmes këtij hulumtimi ne po i kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojmë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe nivele të larta ndërkombëtare, për arsye se ne konsiderojmë që është shumë e rëndësishme që qytetarët të kenë fjalën e tyre në proceset më të rëndësishme të vendit e sigurisht

që siguria, gjyqësia dhe politika e jashtme janë shtylla kyçe", ka thënë Qehaja. Ai shtoi se pakënaqësia e qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë është në rritje dhe kjo sipas tij është shumë shqetësuese. Ndërsa, Arbër Muja nga kjo qendër tha se ky publikim është i bazuar në hulumtimin e opinionit publik dhe është i bazuar në sondazh në anketa.

"Është matur kënaqësia e qytetarëve me institucionet e sigurisë. Institucioni i sigurisë, i cili gëzon kënaqësinë më të madhe të popullata, te të anketuarit është Forca e Sigurisë

së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i, me një përqindje të kënaqësisë deri në 60 për qind, pastaj nga zjarrfikësit, një institucion tjetër, i cili jo drejtpërdrejtë bënë pjesë në një siguri të fortë. Pastaj, Policia e Kosovës me kënaqshmëri prej 42 për qind. Kjo është një kënaqshmëri e balancuar e qytetarëve, kurse institucionet tjera që kanë kënaqshmëri më të vogël janë doganat 29 për qind, EULEX-i 28 për qind, dhe Agjencioni Kosovar i Inteligjencës 13 për qind", ka thënë Muja.

Sipas Mujës, të anketuarit janë pyetur edhe rreth problemeve tjera të sigurisë, dhe politikës, ku qytetarët kanë dhënë mendimet e tyre për këto çështje. Ai tha se mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind të të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind u besojnë në këto bisedime. Sipas kësaj ankete shumica e njerëzve në Kosovë janë optimist se të ardhurat e tyre do të rriten në vitin 2013. Kjo anketë me qytetarë përm-

» « Është matur kënaqësia e qytetarëve me institucionet e sigurisë. Institucioni i sigurisë, i cili gëzon kënaqësinë më të madhe të popullata, te të anketuarit është Forca e Sigurisë së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i, me një përqindje të kënaqësisë deri në 60 për qind, pastaj nga zjarrfikësit, një institucion tjetër, i cili jo drejtpërdrejtë bënë pjesë në një siguri të fortë. Pastaj, Policia e Kosovës me kënaqshmëri prej 42 për qind. Kjo është një kënaqshmëri e balancuar e qytetarëve, kurse institucionet tjera që kanë kënaqshmëri më të vogël janë doganat 29 për qind, EULEX-i 28 për qind, dhe Agjencioni Kosovar i Inteligjencës 13 për qind", ka thënë Muja.

ban edhe shumë pyetja të tjera, të cilat janë bërë publike nga Qendra kosovare për studime të sigurisë.

SHKURT

Kushdetyesja nuk vendos për kompensim të punëtorëve të Çelikut

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka njoftuar se në përgjigje të pyetjeve përkitazi me përmbartimin e aktgjyqimit që ka të bëjë me disa ish-punëtorë të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj, Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur për kompensimin material apo se çfarë shume duhet t'ua ndahet punëtorëve të caktuar, të tregjetat e të cilëve ishin cenuar gjatë procesit të privatizimit të punëdhënësit të tyre.

Sipas kësaj gjykatë, më 6 dhjetor 2012, u publikua vendimi për mospërmbartimin e këtyre aktgjyqimit për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit ende nuk e kishin përmbartuar aktgjyqimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, rasti nr. KI 08/09, 117 dhjetorit 2010.

"Gjykata Kushtetuese rithekson se çështja e kompensimit monetar nuk ishte vendosur me aktgjyqimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila konstatoi se aktgjyqimi i formës së prerë dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj, duhet të përmbahet nga ana e autoriteteve kompetente, konkretisht nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e AKM-së", thuhet në një komunikatë për media të lëshuar nga kjo gjykatë. ■

Komuna e Prishtinës sqaron procedurat tenderuese për Sheshet

Komuna e Prishtinës në një konferencë për medie të bënëën ka sqaruar edhe njëherë procedurat tenderuese të dy shesheve, që janë duke u ndërtuar aktualisht. Në këtë konferencë për medie u tha se procedura tenderuese, të cilën e ka ndjek Komuna e Prishtinës në rastin e dy shesheve ka qenë në përpikëri me ligjet në fuqi, gjë të cilën përmes shkresave që ia ka dërguar komunës, e ka dëshmuar edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publikë dhe Tenderëve. Shkresat që i janë dërguar Komunës së Prishtinës nga ky organ i përkasin datave 11.10.2011, ku OSHP hedh poshtë ankesën e Operatorit Ekonomik "Mozaiku dhe datës 26.06.2012, ku hidhet poshtë ankesa e operatorit ekonomik "Paradiso". Përmes këtyre shkresave

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publikë hedh si të pa baza ankesat e operatorëve të lartpërmendur dhe në të thuhet se "Vërtetohet si i bazuar vendimi i Autoritetit Kontraktues/Komuna e Prishtinës, për dhënieën e kontratës Operatoreve Ekonomik për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Sheshit Ibrahim Rugova", numër të prokurimit AP-616-11-176-511 dhe për aktivitetin ekonomik "Turmizimi dhe montimi i pllakave në Sheshin Ibrahim Rugova". Komuna në mënyrë që jetë sa me transparente dhe e qartë në këtë aspekt të tere dokumentacionin që ka të bëjë me dy sheshet e ka dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe është e gatshme që t'ia ofroj dhe të bashkëpunoj edhe me cdo institucion tjetër, që ka interes ta trajtoj këtë çështje. ■

Nënkryetari Avdullah Hoti në Paris

Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Avdullah Hoti, së bashku me drejtorin ekzekutiv të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare lidhur me rolin e pushtetit lokal në zhvillimin demokratik, promovimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillim, që po mbahet në Paris, me 10 dhe

11 dhjetor 2012. Konferenca organizohet nga ALDA, Asociacioni i Agjencive për Demokraci Lokale, që mbështetet nga Komisioni Evropian. Nënkryetari Hoti paraqiti të arriturat e Komunës së Prishtinës sa i përket promovimit të të drejtave në nivel lokal, siç është zyra për barazi gjinore në komune, zyrtaret për të drejta e njeriut dhe zyra për komunitete, zyrtari për të drejta e fëmijëve, zyrtari për të drejta e personave me aftësi të kufizuara dhe zyrtare të tjerë që promovojnë të drejtat e personave dhe grupeve specifike në komune. ■



Krasniqi priti një grup studentësh të Fakultetit të Edukimit

fotolajm Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, sot, në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit, priti një grup prej 100 studentësh të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës, të shoqëruar nga ligjërues dhe dekan i këtij fakulteti, Et'hem Çeku. Duke iu uruar mirëseardhje në Kuvendin e Kosovës, kryetari Krasniqi përgëzoi studentët për përzgjedhjen e profesionit të mësuesisë dhe kërkoi nga ta përkushtim maksimal në përmbushjen e këtij misioni fisnik. Në vazhdim, kryetari Krasniqi bëri një përshkrim të funksioneve kushtetuese të Kuvendit, rolit, punës dhe përbërjes së tij, ndërsa u ndal në çështje të rëndësishme të punës së përditshme, që lidheshin me mënyrën e vendimmarrjes. Studentët, nga ana e tyre, shfaqën interesim të madh për një varg zhvillimesh në Kosovë, me theks të veçantë, për proceset integruese dhe të ardhmen e vet Bashkimit Evropian. Duke u përgjigjur në çështjet e ngritura, kryetari i Kuvendit konsideroi se rruga euro-atlantike e Kosovës nuk ka alternativë dhe se integrimi në Bashkimin Evropian është interes i kombit shqiptar. Krasniqi foli gjithashtu, edhe për relacionin Kuvend-Qeveri, pozitë-opozitë etj.



Bie besueshmëria në Institucione



FSK-ja institucioni më i besueshëm AKI ia "sheh sherrin" SHIK-ut

Sipas këtij sondazhi, qytetarët e Kosovës më se shumti kanë besim në FSK-në, ky institucion, ndërsa vetëm 13 për qind me punën e AKI-së.

Qytetarët e Kosovës nga të gjitha institucionet e sigurisë në vend, më se shumti i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndërsa në institucionet gjyqësore, qytetarët e vendit tonë kanë shumë pak besim, në anën tjetër çështja e veriut të Kosovës, situata ekonomike dhe korrupsioni shihen si faktorët kryesor që e rrezikojnë stabilitetin politik të Kosovës. Megjithatë, qytetarët e Kosovës nuk kanë frikë nga ndonjë sulm ushtarak nga shteti tjetër, derisa si shtete mike konsiderojnë Shqipërinë, SHBA-në, Turqinë dhe BE-së, ndërsa si shtete armike konsiderojnë Serbinë dhe Greqinë. Këto janë rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri Kosovar i Sigurisë", i realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Drejtori ekzekutiv i kësaj qendre, Florian Qehaja theksoi se programi "Barometri kosovar i sigurisë" ka për qëllim të mas perceptimin e qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë, siç janë policia, FSK-ja, Agjencia e Inteljencës, zjarrfikëset, EULEX-i, KFOR-i, pastaj institucionet e drejtësisë, si dhe perceptimet ndaj vendeve fqinje dhe superfuqive botërore. Drejtori i hulumtimeve në këtë qendër, Armend Muja tha se ky publikim është i bazuar në hulumtimin e opinionit publik dhe është i bazuar në sondazh në anketa. Sipas tij, anketa është realizuar me 1067 amvisën, në gjithë Kosovën dhe struktura e të intervistuarve, përfshin moshën mbi 18 vjeçare. Ai theksoi se 89 % të amvisërve u raportuan të jenë shqiptar, 6.7 %

ishin serb, kurse pjesa tjetër ishin nga komunitetet tjera të Kosovës, një numër, i cili në njëfarë mase reflekton në numrin aktual të popullatës në Kosovë. Sipas këtij sondazhi, qytetarët e Kosovës më se shumti kanë besim në FSK-në, ky institucion pasohet nga KFOR-in me një shkallë të besueshmërisë prej 60 për qind, pastaj nga zjarrfikësit, derisa vetëm 42 për qind janë të kënaqur me punën e policisë, por 22 për qind të qytetarëve janë të kënaqur me punën e EULEX-it, ndërsa vetëm 13 për qind me punën e AKI-së. Por, derisa qytetarët janë shprehur se KFOR-i është fer dhe i paanshëm, nuk e ndajnë të njëjtin mendim për EULEX-in, kurse 87 për qind e të anketuarve mendojnë se FSK-ja duhet të shndërrohet në ushtri. Sa i përket gjyqësorit, të anketuarit në institucionet e drejtësisë. Sa i takon stabilitetin politik në vend, vlerësohet se çështja e veriut të Kosovës, situata ekonomike dhe korrupsioni në përgjithësi shihen si faktorët kryesor që e rrezikojnë këtë stabilitet në vend. Sipas këtij sondazhi, po ashtu del se qytetarët e Kosovës nuk janë të kënaqur me gjendjen politike në vend. Gati 60 për qind e të intervistuarve vlerësovan situatën e tanishme politike si të keqe. Respondentët e anketuarit ishin të ndarë në dysh sa i përket dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku 47 për qind deklaruan se mbështetnin dialogun. Kyçiguria ekonomike e qytetarëve është në gjendje shumë të rëndë. Vetëm pesë për qind kanë të ardhura të mjaftueshme sa për të kursyer, ndërsa vetëm 26 për qind iu mjaftojnë të ardhurat që kanë për jetesë. Sipas këtij sondazhi, sa i përket sigurisë shoqërore, qytetarët i shohin si rreziqe shumë të larta armët pa leje, vjedhjet, vrasjet drogat dhe alkoolin, në krahasim me rreziqet nga konfliktet ndëretnike. ■ **Maria Nikolla**

7

planetë në Rrugën e Qumështit, brenda galaksisë në të cilën ndodhet sistemi ynë diellorë janë veçuar nga kërkuesit e NASA-së, si pjesë e një projekti, i cili synon të identifikojë të gjithë planetët në të cilat mund të ketë jetë.

mbrojtje ligjore

"Dikush të kujdeset për ne"

"Asnjëherë nuk mund të flejë e qetë, çdo herë i shoh në ëndërr. Bashkëshorti im, i cili është i sëmurë dhe i papunë, thotë se, kam nevojë për mjekim pasi që shpesh herë nuk e di se çka bëjë dhe filloj edhe të bërtas sa herë dëgjoj në lajme për serbët apo bisedimet me Serbinë. Ne po jetojmë të poshtëruara dhe në pamundësinë për të na mbështetur dikush, andaj lutem shumë që së paku të jemi të mbrojtura nga shteti apo të kemi dikë që do të mund të kujdeset për ne, sepse neve kemi shumë nevojë për kujdes", shpjegon H. M.


asgjë për rehabilitimin institucional për personat e dhunuar gjatë luftës, të cilët i kanë mbijetuar abuzimit seksual gjatë luftës e që vazhdojnë të viktimizohen edhe më tutje pamëshitetje" ka thënë ajo, duke shtuar se Levizja "Vetëvendosje" konsideron se perdhunimet të cilat janë kryer gjatë luftës se fundit në Kosovë janë formë e krimit kundër njerëzimit dhe për këtë arsye personat e dhunuar gjatë luftës duhet të njihen si viktimë dhe duhet të kenë mbështetje institucionale. "Ne si 'Vetëvendosje' kemi proceduar në

Kuvend Ligjin për plotësim ndryshim për statut të drejtat e dëshmoreve, invalideve, veter-

luftës dhe të ndërmarrin masa për demshperblimin e tyre. Ndërsa kërkesa tjetër drejtuar Qeverisë është ajo që në ligjin mbi asistencën sociale, i cili është duke u rishikuar, gratë e dhunuara gjatë luftës të përfshihen në listën dhe në ligjin e veteraneve të luftës. Po ashtu është kërkuar edhe plotësim-ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmoreve invalideve, veteraneve pjesëmtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës e familjareve të tyre. Ky projektligj ka për qëllim njohten e statusit të viktimave të abuzimit seksual e të dhunimit dhe mbështetjen institucionale për këtë kategori.

**Përkrahja
institucionale**
Albulena Haxhiu,
deputete e Kuvendit

20



Sipas sondazhit
"Barometri Kosovar i Sigurisë"

» FSK-ja më e besueshmja

48

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka shpallur rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri Kosovar i Sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës, ka dalë të jetë më e besueshmja, ndërsa si më e pabesueshmja ka dalë të jetë Agjencia Kosovare e Inteligjencës. Në këtë sondazh, mbi 60 per qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 per qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 per qind e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë - Serbi, ndërsa prej serbeve të anketuar 55 per qind besojnë në këto bisedime. Drejtori ekzekutiv i kesaj qendre, Floran Qehaja, ka thënë, se programi barometri kosovar i sigurisë ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë, siç janë policia, FSK-ja, Agjencia e Inteligjencës, zjarrfikësit, EULEX-i, KFOR-i, pastaj institucionet e drejtësisë, siç janë gjykatat, prokuroritë, si dhe perceptimet ndaj vendeve fqinje dhe superfuqive botërore. "Përmes këtij hulumtimi ne po i kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojmë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe nivele të larta ndërkombëtare, për arsye se ne konsiderojmë që është shumë e rëndësishme që qytetarët

për qind e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë - Serbi

ta kenë fjalën e tyre në proceset më të rëndësishme të vendit, e sigurisht që siguria, gjyqësia dhe politika e jashtme janë shtylla kyçe", ka thënë Qehaja. Ai shtoi se pakënaqësia e qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë është në rritje dhe kjo, sipas tij, është shumë shqetësuese. Ndërsa, Arber Muja nga kjo qendër, tha se, ky publikim është i bazuar në hulumtimin e opinionit publik dhe është i bazuar në sondazh në anketë. "Është matur kënaqësia e qytetarëve me institucionet e sigurisë. Institucioni i sigurisë, i cili gëzon kënaqësinë më të madhe të popullata, tek të anketuarit është Forca e Sigurisë së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i, me një përqindje të kënaqësisë den në 60 per qind, pastaj nga zjarrfikësit, një institucion tjetër, i cili jo drejtpërdrejt bën pjesë në një siguri të fortë. Pastaj, Policia e Kosovës me 42 per qind. Kjo është një kënaqshmëri e balancuar e qytetarëve, kurse institucionet tjera që kanë kënaqshmëri më të vogël janë doganat 29 per qind, EULEX-i, 28 per qind, dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës 13 per qind", ka thënë Muja.

tour operator
OFERTAT E DIMRIT
*Çmimi i kalkuluar për person

Oferta Individuale

BIANCA - 110 eur
Kolashin. Mali i Zi
14.12.2012 - 16.12.2012

RADIKA - 269 eur
Mavrove, Maqedoni
22.12.2012 - 25.12.2012

SKIJIMI NE BANSKO
Bulgari. Janar 2013
filluar nga 30 eur

Oferta VITI i Ri 2013.

★★★★☆

DUBROVNIK
Me Gala 249 eur
30.12.2012 - 02.01.2013

★★★★☆

ISTANBUL - 349 eur
29.12.2012 - 02.01.2013

★★★★☆

VENECIA - 395 eur
30.12.2012 - 02.01.2013

★★★★☆

VJENË - 625 eur
30.12.2012 - 03.01.2013

★★★★☆

DUBAI - 695 eur
27.12.2012 - 03.01.2013

★★★★☆

PARIS - 795 eur
27.12.2012 - 03.01.2013

Më shumë i besojnë FSK sesa AKI

Prishtinë, 10 dhjetor - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka shpallur rezultatet preliminare të sondazhit "Barometri Kosovari i Sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës, ka dalë

të jetë më e besueshmja, ndërsa si më e pa besueshmja ka dalë të jetë Agjencioni Kosovari i Inteligjencës. Në këtë sondazh, mbi 60 për qind të qytetarëve e vlerësojnë situatën politike të keqe, rreth 52 për qind nuk i besojnë sistemit zgjedhor në Kosovë, 48 për qind

e të anketuarve shqiptarë nuk u besojnë bisedimeve Kosovë-Serbi, ndërsa prej serbëve të anketuar 55 për qind besojnë në këto bisedime. Drejtori ekzekutiv i kësaj qendre, Florian Qehaja ka thënë se programi barometri kosovar i sigurisë ka për qëllim të bëjë

matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë, siç janë policia, FSK-ja, Agjencia e inteligjencës, zjarrfikësit, EULEX-i, KFOR-i, pastaj institucionet e drejtësisë, siç janë gjykatat, prokuroritë, si dhe perceptimet ndaj vendeve fqinje dhe superfuqive botërore.

"Përmes këtij hulumtimi ne po i kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojmë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve të mbizotërojë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe nivele të larta ndërkombëtare," ka thënë Qehaja.